



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 04.06.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 01.06.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik **N.SH.T. "Viktory Com"**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Ndërtimi i shtegut për ecje dhe ciklizëm Çabrat-Jahoc"**, me Nr. të Prok: 632-20-1308-5-2-1 nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet si** e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik **N.SH.T. "Viktory Com"**, e dt. 01.06.2020, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Ndërtimi i shtegut për ecje dhe ciklizëm Çabrat-Jahoc"**, me Nr. të Prok: 632-20-1308-5-2-1, kundër **NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES**, të AK –së, të datës 28.05.2020 të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **Vërtetohet NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES** të publikuar me datë: 28.05.2020;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në platformën elektronike të KRPP-së.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik **N.SH.T. "Viktory Com"**, me datë 01.06.2020, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull **"Ndërtimi i shtegut për ecje dhe ciklizëm Çabrat-Jahoc"**, me Nr. të Prok: 632-20-1308-5-2-1.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 04.06.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj I-rë se:

Grupit të operatorëve ekonomik “Joos & Krasniqi-Bazë” sh.p.k. & N.P.N.”Vizion Plus”, ju mungon nr.i prokurimit në Deklaratën nën Betim, nuk qëndron , sepse Deklarata nën betim e Grupit të operatorëve ekonomik “Joos & Krasniqi-Bazë” sh.p.k. & N.P.N.”Vizion Plus”, është identike me deklaratën në dosjen e tenderit;

Pretendimi juaj i II-të se:

Grupit të operatorëve ekonomik “Joos & Krasniqi-Bazë” sh.p.k. & N.P.N.”Vizion Plus”, nuk ka referenca të natyrës së ngjajshme ku ceket ndërtimi i shtegut por vetëm asfaltimi i rrugëve, nuk qëndron sepse si ndërtimi i shtigjeve ashtu edhe asfaltimi i rrugëve hyjin te ndërtimet e ulëta, prandaj mirret se janë të natyrës së ngjajshme;

Pretendimi juaj i III-të se:

Operatorit ekonomik NNSH “Korben”, i mungon emri i kompanisë në rreshtin e parë të Deklaratës nën Betim dhe numri i prokurimit,se nuk ka referenca të ngjashme dhe nuk i ka të regjistruar kamionat e transportit nuk qëndron, sepse Deklarata nën Betim Operatorit ekonomik NNSH “Korben”, është identike me deklaratën në dosjen e tenderit dhe tabela është e plotësuar,nënshkruar dhe vulosur, kështuqë mos vënia e emrit në rreshtin e parë nuk është arsye për eliminim.Sa i përket referencave po përsërisim se ndërtimi i shtigjeve ashtu edhe asfaltimi i rrugëve hyjin te ndërtimet e ulëta, prandaj mirret se janë të natyrës së ngjajshme.Mos regjistrimi i kanionëve gjithashtu nuk është arsye për eliminim, sepse për shkak të pandemisë të gjithë kanë qenë të liruar nga rexhistrimi i automjeteve.

Pretendimi juaj i IV-të se:

Operatorit ekonomik “D&T Group”, ka gabime në Deklaratën nën Betim - i mungon nr.prokurimit dhe nuk ka kontratë për buldozher, nuk qëndron sepse Deklarata nën Betim e Operatorit ekonomik “D&T Group”, është identike me deklaratën në dosjen e tenderit, kurse sa i përket buldozherit i njëjti ka kontratë trivjeçare(2019-2021) me kompaninë “PE-VLA-KU” sh.p.k.;

Pretendimi juaj i V-të , që ka të bëjë me Grupin e operatorëve ekonomik Compania Tini sh.p.k. & “DAZAN GROUP”, është i pakuptimt, pasi që i njëjti është eliminuar;

Sa ju përket juve, tenderi juaj nuk është i suksesshëm për arsye se çmimi i juaj nuk është më i ulëti në mesin e tenderëve që plotëson kërkesat e Autoritetit Kontraktues.

Pas rishikimit të dokumenteve, Autoriteti Kontraktues, konstaton se Grupi Operatorëve ekonomik “Joos & Krasniqi-Bazë”sh.p.k. & N.P.N.”Vizion Plus”, i plotëson të gjitha kushtet e kërkuara në dosjen e tenderit dhe Autoriteti Kontraktues, mbetet pranë vendimit të marrë.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

Faton Gutaj
Menaxher i Zyrës së Prokurimit



Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;
Arkivit të Komunës